




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS
TUŽILAÇKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

BULETINI I KËSHILLIT
PROKURORIAL TË
KOSOVËS 2024



Prishtinë, 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-së për muajin tetor të vitit 2024)



Kryesuesi Hajdaraj priti në takim shefin e ri të Zyrës së BE-së në Kosovë, Aivo Orav

Prishtinë, 1 tetor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, priti në një takim njohës shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Aivo Orav, së bashku me bashkëpunëtorët e tij.

Fillimisht, z. Hajdaraj i uroi suksese z. Orav me rastin e marrjes së detyrës së re, duke shprehur mirënjojen dhe falënderimin e tij për institucionet e Bashkimit Evropian që mbështesin në vazhdimësi realizimin e misionit, objektivave dhe synimeve të sistemit prokurorial.

Ndër të tjera, gjatë këtij takimi, Kryesuesi Hajdaraj e njoftoi shefin e Zyrës së BE-së, z. Orav, edhe për proceset aktuale dhe për sfidat në rrugën përpëra që ndërlidhen me çështjet e sundimit të ligjit dhe që janë në funksion të fuqizimit të llogaridhënis, transparencës dhe integritetit në sistemin prokurorial.



Nga ana tjeter, Ambasadori Orav, tha se prioritet i institucioneve të BE-së do të mbetet përkrahja e vazhdueshme për avancimin dhe fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë dhe mbështetja e një sistemi prokurorial të pavaruar.

Përfundimisht, bashkëbiseduesit Hajdaraj-Orav, shprehën në takimin e sotëm përkushtimin dhe gatishmërinë e tyre për vazhdimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të mëtejshëm të agjendës së përbashkët evropian.



Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, priti në takim Ambasadorin e Francës në Prishtinë, z. Olivier Guérot

Prishtinë, 3 tetor 2024- Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Ardian Hajdaraj, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi, priti në takim Ambasadorin e Francës në Prishtinë, z. Olivier Guérot, me bashkëpunëtorë.


Takimi ndërmjet z. Hajdaraj dhe z. Guérot është zhvilluar në fryshtëzime e bashkëpunimit reciprok, me ç'rast Kryesuesi Hajdaraj falënderoi në mënyrë të veçantë Ambasadorin francez për vizitën e tij të parë, duke shprehur vullnetin dhe përkushtimin e madh të tij për të zhvilluar partneritetin e përbashkët në fushat përkatëse, në mënyrë që të ketë avancim dhe fuqizim të rendit dhe sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.



Nga ana tjetër, Ambasadori i Francës, z. Guérot, duke falënderuar Kryesuesin Hajdaraj për pritjen, theksoi se misioni diplomatik i Francës mirëpret dhe angazhohet përfuqizimin e sistemit prokurorial.



Z.Hajdaraj dhe z.Guérot u pajtuan gjatë këtij takimi që iniciativat e përbashkëta në kuadër të bashkëpunimit dypalësh për forcimin e rendit dhe zbatimin e ligjit të jetësohen duke u fokusuar pikërisht në proceset e reformave në sistemin e drejtësisë në Kosovë dhe në suaza të koordinimit të mëtejshëm të agjendës së përbashkët evropiane.





Mbahet Takimi i 254-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 7 tetor 2024 - Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Arđan Hajdaraj, mbajti Takimin e 254-të me radhë.

Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

1. Themeloi Panelin Hetimor për shkeljet disiplinore të një (1) prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe
2. Miratoi Raportin e Panelit Hetimor për shkeljet disiplinore të dy (2) prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Prizren, ndërsa vendimi i KPK-së do të publikohet në përputhje me ligjin në fuqi.





Kryesuesi Hajdaraj priti në takim përfaqësuesit e Administratës Gjyqësore të Norvegjisë

Prishtinë, 8 tetor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Ardian Hajdaraj, së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi dhe Udhëheqësin e Departamentit të Teknologjisë Informatike në SKPK, Nexhat Haziri, ka pritur në takim përfaqësuesit e Administratës Gjyqësore të Norvegjisë, Audun Hognes Berg dhe Amra Jasarevic.

Që në fillim të takimit, Kryesuesi Hajdaraj njoftoi përfaqësuesit norvegjezë për zhvillimet aktuale, me theks të veçantë në të arriturat sa i përket zbatimit dhe menaxhimit efikas të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në të gjitha prokuroritë e vendit, si dhe për aktivitetet që janë të përfshira në pakon ligjore.



Ndër temat kryesore që janë diskutuar sot ishin edhe ato që kanë të bëjnë me sfidat kryesore të SMIL-it, kapacitetet e sistemit prokurorial për përmirësimin dhe mirëmbajtjen e SMIL-it dhe qëndrueshmërinë financiare, të cilat ndikojnë në menaxhimin e shërbimeve adekuate dhe ofrimin e shërbimeve për përdoruesit, si dhe në përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe lehtësimin e qasjes së qytetarëve në prokuroritë e vendit.



Nga ana tjetër, zyrtarët norvegjezë të Administratës Gjyqësore të Norvegjisë, theksuan se vlerësimi dhe bashkëpunimi me sistemin prokurorial të Kosovës mbetet objektiv i tyre për të vazhduar mbështetjen me qëllim që sistemi elektronik të avancohet edhe më shumë.

Z.Hajdaraj dhe përfaqësuesit e Administratës Gjyqësore të Norvegjisë në përbyllje të takimit janë pajtuar që të kenë fokus në çështjet që kanë të bëjnë me digitalizimin e plotë të sistemit prokurorial, duke pasur parasysh edhe ndryshimet ligjore që mund të ndodhin në të ardhmen.





Anëtari i KPK-së, Visar Krasniqi merr pjesë në tryezën për shënimin e "10 tectorit, Ditës Botërore të Shëndetit Mendor"

Prishtinë, 9 tetor 2024 - Është mbajtur tryeza e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit për ndër të shënimit të "10 tectorit, Ditës Botërore të Shëndetit Mendor", ku mori pjesë anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Visar Krasniqi.

Në fjalën e tij, Krasniqi theksoi rëndësinë e zbatimit të të drejtave të njeriut, siç është përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ai vuri në dukje se, me gjithëse legjislacioni në Kosovë është i avancuar për mbrojtjen e të drejtave të personave me probleme mendore, sfidat e zbatimit mbeten të mëdha.

Krasniqi, theksoi se Ligji për Shëndetin Mendor, i cili ka hyr në fuqi në vitin 2015, ka paraparë nxjerrjen e gjashtë akteve nënligjore brenda një viti, por deri tani nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim.



Anëtari i KPK-së, ka cekur se tashmë kur Republika e Kosovës ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj si dhe Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese do të jenë të rëndësishme për këtë proces dhe si institucionet duhet të vendosim prioritetet tona në mënyrë që ekspertet fakte mbledhës kur vijnë në Kosovë të na gjejnë se kemi plotësuar të gjitha standartet e kërkura.

Krasniqi shpjegoi se, në procedurat penale, prokurori fillimisht përcakton shkallën e përgjegjësisë penale të individëve me probleme mendore dhe se është e



Gjithashtu, ai potencoi rëndësinë e mbajtjes së këtyre personave në qendra të veçanta të paraburgimit, të ndarë nga ata pa probleme mendore, për t'u siguruar një trajtim të duhur dhe përkujdesje nga stafi i specializuar, duke pasur parasysh rezikun që këta individë mund të kenë për veten ose të tjérët.

Në fund Krasniqi, përfundoi duke shprehur angazhimin e Këshillit Prokurorial për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut, veçanërisht për personat me çrregullime mendore. Në këtë tryezë morën pjesë përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor, Shërbimi Korrektues, Zyra e Kryeministrit, psikiatria forenike, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar, si dhe nga shoqëria civile.





Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 9 tetor 2024 - Komisioni për Administrim të Prokurorive, i kryesuar nga Jetish Maloku, i cili ka marrë pjesë përmes platformës online për shkak të një vizite jashtë vendit, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit, me ç'rast janë trajtuar pikat sipas rendit të paraparë.

Në takimin e Komisionit për Administrim të Prokurorive është bërë prezantimi i analizës për numrin e nevojshëm të prokurorëve në prokuroritë themelore, me fokus të veçantë në prokuroritë që kanë numër të pamjaftueshëm të prokurorëve.



Një temë tjetër, për të cilën u diskutua në këtë takim, ishte edhe planifikimi për ndërtimin e objektit të ri te Pallati i Drejtësisë, me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për Prokurorinë Themelore të Prishtinës. Në përbomyllje u tha që ky takim shërbeu për identifikimin e sfidave dhe nevojave në sistemin prokurorial, duke theksuar rëndësinë e infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme për një funksionim të rregullt dhe efektiv.





Reagim i përbashkët i KPK-së dhe Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit ndaj kërcënimeve të Zëvendëskryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, z. Ersan Qavolli

Prishtinë, 11 tetor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), dënojnë ashpër kërcënimet e bëra përmes rrjeteve sociale ndaj prokurorit të Departamentit për Krime të Rënda, njëkohësisht Zëvendëskryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Pejë, z. Ersan Qavolli, të cilat vijnë si rrjedhojë i punës së tij zyrtare që ndërlidhen me veprimet e ndërmarrë nga Prokurori i Shtetit për rastin e plantacioneve me bimë narkotike, të zbuluara kohëve të fundit.

KPK dhe ZKPSH, theksojnë se këto kërcënime janë akte të shëmtuara, të papranueshme dhe të patolerueshme, andaj ua bëjnë me dije atyre që fshihen prapa tyre se janë të vendosur të qëndrojnë fuqishëm në përkrahje të prokurorit Qavolli dhe do t'i ofrojnë mbështetje të plotë për punën e tij në ndjekjen e kryeseve të veprave penale.



KPK dhe ZKPSH, njoftojnë se në bashkëpunim me institucionet e tjera ligjzbatuese janë duke u ndërmarrë të gjitha veprimet dhe masat konkrete për identifikimin dhe arrestimin e personave që kanë kërcënuar prokurorin Qavolli dhe, njëkohësisht, janë duke e trajtuar seriozisht këtë veprim penal gjëri në ndriçimin e plotë të tij, i cili ka për qëllim pengimin në ushtrimin e funksionit dhe detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore.

Në këtë drejtim, KPK-ja dhe ZKPSH-ja, sigurojnë opinionin publik se kërcënimet dhe shantazhet e tillë, çfarëdo qofshin dhe nga kushdo qofshin, të cila bëhen ndaj prokurorëve të shtetit nuk do t'i zmbrapsin asnjëherë synimet dhe përpjekjet e vazhdueshme për fuqizimin e shtetit ligjor në Kosovë.



Reagim i KPK-së dhe ZKPSH-së për kërcënimet ndaj U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Petrit Kryeziu dhe organeve të sigurisë

Prishtinë, 11 tetor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), dënojnë ashpër edhe një kërcënim tjetër që është bërë gjatë ditës së sotme përmes rrjeteve sociale ndaj U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Petrit Kryeziu dhe ndaj organeve të sigurisë. Edhe ky kërcënim ka ardhur për shkak të punëve zyrtare që kryejnë këto organe, përfshirë edhe z. Kryeziu në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të kësaj prokurorie.

KPK dhe ZKPSH deklarojnë se këto kërcënime janë të drejtuara edhe ndaj organeve të Policisë së Kosovës dhe organeve të ndjekjes dhe përbajnjë edhe ngjyrime dhe emërtime të individëve dhe organizata kriminale dhe duken qartazi se qëllimi i tyre është ndërhyrja në punët e Prokurorit të Shtetit dhe organeve të sigurisë së vendit.

KPK dhe ZKPSH, gjithashtu, me këtë rast, ua bëjnë me dije individëve të tillë se përkrahin fuqishëm z. Kryeziu dhe organet e sigurisë, si dhe i mbështesin plotësisht në punën e misionin e tyre për ndjekjen dhe hetimin e kryeseve të veprave penale.

KPK dhe ZKPSH, theksojnë se kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjor dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera janë të angazhuar për të bërë identifikimin dhe arrestimin e kërcënuesve të U.D. Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Petrit Kryeziu dhe përfaqësuesve të organeve të sigurisë dhe nuk do të ndalen deri në ndriçimin e plotë të këtij rasti.

Me këtë rast, këto institucione të pavarura dhe kushtetuese, nënvizojnë për të dytën herë gjatë ditës së sotme, se kërcënimet e tillë nuk do të zmbropsin përkushtimin, synimet dhe përpjekjet e pandalshme për fuqizimin e shtetit ligjor në Kosovë.





Miratohet Raporti finansiar për nëntëmujorin e vitit 2024

Prishtinë, 14 tetor 2024-Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe udhëheqëset e njësive organizative për buxhet dhe financa.



Në këtë takim fillimi është bërë shqyrtimi i Raporti Finansiar për nëntëmujorin e vitit 2024, me ç'rast janë trajtuar shpenzimet sipas programeve dhe kategorive ekonomike dhe i njëjtë është miratuar nga anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel. Raporti finansiar për periudhën janar- shtator 2024 përmban të dhënat për realizimin, ecurinë dhe treguesit relevantë të përbushjes së planit të rrjedhës së parasë për të gjitha programet buxhetore të Këshillit dhe kategorive ekonomike.



Miratohet shpallja e konkursit për Kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit dhe të pesë prokurorive themelore

Prishtinë, 15 tetor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Arđan Hajdaraj, mbajti Takimin e 255-të, në të cilin diskutoi pikat e parapara në rendin e ditës. Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial I Kosovës:

1. Miratoi shpalljen e Konkursit për Kryeprokurorin e Prokurorisë së Apelit dhe konkursin për pesë kryeprokurorë të prokurorive themelore në: Prizren, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë dhe Pejë, nga data 21 tetor 2024;



2. Themeloi dy panele vlerësuese për kandidaturat për Kryeprokuror të Prokurorisë së Apelit dhe për kryeprokurorë të pesë prokurorive;
3. Miratoi Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Stafit Administrativ në Sistemin Prokurorial me propozimet dhe ndryshimet e bëra nga anëtarët e Këshillit gjatë këtij takimi, rregullore kjo, që hynë në fuqi nga dita e sotme;
4. Aprovoi Dokumentin e politikave të trajnimit dhe Planin i nevojave për trajnim për vitin 2025;
5. Caktoi prokuoren Merita Bina Rugova në detyrën e Udhëheqëses së Departamentit për Hetimin e Krimit të Organizuar në Prokurorinë Speciale me mandat katërvjeçar;
6. Aprovoi dorëheqjen e prokurorit Arianit Salihu nga detyra e Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
7. Caktoi prokurorin Besart Mustafa në detyrën e Udhëheqësit të Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë me mandat katërvjeçar;
8. Liroi nga ngarkesa më lëndë në masën prej 30 përqindësh Udhëheqësin e Departamentit për Krime të Rënda dhe Udhëheqësin e Departamentit për të Mitur, kurse në masën prej 50 përqindësh Udhëheqësin e Departamentit të Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prishtinë deri në nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ;



9. Refuzoi kërkësën e prokurorit Qazim Xharra për ricaktimin e tij në Prokurorinë Themelore në Prizren;
10. Aprovoi dërgimin e propozimit për lirim nga detyra të prokurorit Dushko Manitasheviq te Presidentja e vendit për shkak të arritjes së moshës së pensionimit;
11. Liroi deri më 31 dhjetor 2024 nga pranimi i lëndëve në masën prej 50 për qind prokuoren e Prokurorisë së Apelit, znj. Nazan Shero, e cila është anëtare e Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve dhe
12. Autorizoi Kryesuesin Hajdaraj për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës për shkëmbimin e parcelës, e cila është në pronësi të KGJK-së te Pallati i Drejtësisë me ndërtesën e KPK-së në Objektin C te Pallati i Drejtësisë, e cila është duke u shfrytëzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.





Mbahet takimi i Komisionit për Çështje Normative

Prishtinë, 21 tetor 2024 – Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e komisionit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së. Qëllimi i takimit ishte trajtimi dhe diskutimi i draftit të Rregullores për Vlerësimin e Rezultateve të Punës së Stafit Administrativ.

Gjithashtu, në këtë takim është bërë edhe analizmi i Draftrregullores për Themelin e Marrëdhënieve së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar në Sistemin Prokurorial, draft ky, i cili do të publikohet për dëgjim publik në faqen zyrtare të sistemit prokurorial.



Në përmbyllje të takimit është diskutuar edhe për draftimin e Udhëzuesit për panelin vlerësues për zbatimin e Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, me ç'rast është autorizuar Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së për të përgatitur draftin filletar dhe të njëjtin të sjellë para anëtarëve të Komisionit për Çështje Normative.





Reagim i KPK-së dhe ZKPSH-së ndaj deklaratave të deputetit të Kuvendit të Kosovës, Armend Muja, për Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale

Prishtinë, 22 tetor 2024 – Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) dënojnë ashpër deklaratat e deputetit të Kuvendit të Kosovës, Armend Muja, të bëra sot përmes rrjeteve sociale, ndaj Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale, z.Blerim Isufaj.

Deklaratat e sotme të deputetit Muja kanë përbajtje të pastër politike dhe vijnë e renditen në sinkron me deklaratat e Qeverisë dhe nga radhët e deputetëve të subjektit shumicë në Kuvendin e Kosovës, që, faktikisht, duhet tëjenë gardianë të së drejtës dhe sundimit të ligjit në vendin tonë dhe jo të ndërhyjnë orë e çast, duke mos zgjedhur mjete dhe metoda për të njollosur dhe sulmuar prokurorë, kryeprokurorë dhe prokuroritë e vendit.



KPK dhe ZKPSH theksojnë se këto deklarata kanë për synim të dëmtojnë rastet hetimore në procedurë dhe prononcimet e tillë nuk i shërbijnë drejtësisë, si dhe janë ndërhyrje e qëllimshme për të zhvendosur vëmendjen nga zbatimi i përditshëm i ligjit që bënë Kryeprokurori Isufaj, por me këtë rast, KPK-ja dhe ZKPSH-ja ia bëjnë me dije deputetit Muja se përkrahin dhe mbështesin fuqishëm z.Blerim Isufaj dhe secilin prokurorë, që, çdo ditë, në mënyrë aktive dhe sistematike, merren me ndjekjen dhe hetimin e kryesve të veprave penale kushdo qofshin dhe ngado që vijnë ata.

KPK dhe ZKPSH nën vizojnë gatishmërinë dhe përkushtimin e pandalshëm të Kryeprokurorit Isufaj dhe përgjithësisht të secilin institucion të Prokurorit të Shtetit që kanë në rrugën drejt zbatimit të ligjit, kurse synimet dhe përpjekjet do të janë të pandalshme përfuqizimin e shtetit ligjor në Kosovë.

Efikasiteti, cilësia e punës së prokurorive dhe monitorim i statistikave në SMIL, temë e punëtorisë së Grupit Punues të Përdoruesve

Prishtinë, 25 tetor 2024 – Në kuadër të avancimit të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe për të mbështetur efikasitetin dhe cilësinë e punës së prokurorive me anë të monitorimit të rregullt të statistikave dhe përdorimit të shablloneve në SMIL, u organizua një punëtori dyditore nga Grupi Punues të Përdoruesve të Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL), i udhëhequr nga prokurori Admir Shala. Kjo punëtori është mbështetur nga CEPEJ-i, në të cilën morën pjesë anëtarët e Grupit punues të SMIL, zyrtarë e Departamentit të TI dhe të Njësitetit për Shqyrtimin e Përformancës së Prokurorisë (NJSHP) dhe ekspertë të CEPEJ-it.



Në sesionet e mbajtura për dy ditë me radhë pati diskutime për përcaktimin formave të reja të raporteve statistikore të SMIL-it, sigurimin e cilësisë së të dhënave në SMIL dhe avancimi i shablloneve të gjeneruar automatikisht.

Më këtë rast, u tha se hapat e planifikuar avancues janë në përputhje me metodologjinë e CEPEJ-it, me ç'rast udhëheqësi i takimit të Grupit punues, z. Admir Shala, nën vizoi rëndësinë e marrjes së praktikave të mira dhe zbatimit të standardeve të larta për cilësinë e të dhënave, statistikave dhe shabllonëve.

Në përmbyllje u diskutua përfitimi i madh nga përdorimi i statistikave për shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe financiare, por, sipas pjesëmarrësve, objektivi kryesor mbetet përmirësimi i mbledhjes, i analizimit dhe i përdorimit të statistikave për të avancuar cilësinë dhe efikasitetin e prokurorive, të cilat do të vazhdojnë të trajtohen në rrugën drejt fuqizimit dhe avancimit gjithnjë e më të madh të SMIL-it në të ardhmen.

Dhurimi vullnetar i gjakut, iniciativë e realizuar ndër vite në sistemin prokurorial

Prishtinë, 29 tetor 2024 – Në kuadër të aksioneve të dhurimit të gjakut, Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Prokurori i Shtetit (PSH), në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzion të Gjakut (QKKTGJ), kanë organizuar sot ditën e dhurimit vullnetar të gjakut.

Kjo iniciativë humane është kryer nën kujdesin e ekipit mjekësor të QKKTGJ-së në ambientet e KPK-së, të cilës iu përgjigjen 16 punonjës të sistemit prokurorial, me ç'rast përfaqësuesit e ekipit mjekësor të QKKTGJ-së falënderuan dhe shprehën mirënjojje për dhuruesit vullnetarë.

Dhurimi i gjakut është realizuar për vite me radhë në sistemin prokurorial dhe konsiderohet si një akt i domosdoshëm humanitar për shpëtimin e jetës së njerëzve.





Reagim ndaj kërcënimit të prokurores Lumturije Hoxha dhe zëdhënësit Shkodran Nikçi në Prokurorinë Themelore në Pejë

Prishtinë, 30 tetor 2024- Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), përmes këtij reagimi, dënojnë ashpër kërcënimin e bërë përmes telefonit ndaj prokurores Lumturije Hoxha dhe zëdhënësit Shkodran Nikçi në Prokurorinë Themelore në Pejë, kërcënim ky, që ndërlidhet me trajtimin e rastit të motrës së të dyshuarit me inicialet A.M.

Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, njoftojnë opinionin e gjerë publik se kërcënim i bërë përmes telefonit dhe dyshimet për përcjellje me veturë kanë të bëjë me punët zyrtare që kryejnë znj. Hoxha dhe z. Nikçi, andaj me këtë rast janë ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë së bashku me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera për të nxjerrë sa më parë autorët e kësaj vepre penale para organeve të drejtësisë.

Gjithashtu, këto dy institucione të sistemit prokurorial, ua bëjnë me dije individëve të tillë që ndërhyjnë për të frikësuar prokurorët dhe stafin tjetër, me qëllimin e vetëm që të pengojnë zbatimin e ligjit në vend, se KPK dhe ZKPSH mbështesin fuqishëm prokuroren Hoxha dhe zëdhënësin Nikçi, në punën dhe misionin e tyre të hetimit të kryeseve të veprave penale dhe të zbatimit të transparencës para opinionit publik.

Andaj, përmes këtij reagimi të përbashkët, KPK-ja dhe ZKPSH-ja, theksojnë përfundimisht se veprimet e tillë s'do të zmbrapsin asnjëherë përkushtimin, synimet dhe përpjekjet e pandalshme për fuqizimin e shtetit ligjor në Kosovë.





Drejtori Istrefi mban takim me stafin drejtues të SKPK-së dhe administratorët e prokurorive të vendit

Prishtinë, 30 tetor 2024 – Në kuadër të zhvillimit të aktivitetave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Drejtori i Përgjithshëm, z. Sami Istrefi, mbajti një takim me stafin drejtues të SKPK-së dhe administratorët e të gjitha prokurorive të vendit.

Qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi për planifikimin e proceseve të punës së administratës në periudhën aktuale, si dhe atyre deri në përmbyllje të vitit 2024 dhe planifikimet e nevojshme për vitin 2025.

Fillimisht, Drejtori Istrefi, theksoi nevojën e domosdoshme të avancimit, ngritjes së efikasitetit dhe zbatimit të obligimeve që dalin nga mandatet e administratorëve të prokurorive të vendit, pas hyrjes në fuqi të disa rregulloreve që kanë të bëjnë me mbarëvajtjen dhe funksionimin e administratës së sistemit prokurorial.

Gjithashtu, me këtë rast janë trajtuar edhe çështjet e fuqizimit të komunikimit publik, zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, kërkesat për të dhëna statistikore dhe informata për media, shoqërinë civile dhe të interesuarit e tjera.

Në fund të takimit është nënvizuar rëndësia e vlerësimit të nevojshëm të përformancës periodike dhe vjetore të stafit administrativ në sistemin prokurorial.







Miratohet lista përfundimtare me emrat e 24 prokurorëve të rinj të shtetit që do të dërgohen për dekretim tek Presidentja e vendit

Prishtinë, 31 tetor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 256-të, në të cilin diskutoi pikat e rendit të ditës. Vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

1. Miratoi Udhëzuesin për Panelin Vlerësues në zbatim të Rregullores 07/2024 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës;
2. Miratoi Raportin e Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, të cilin e prezantoi kryetari i Komisionit rekrutues, Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj dhe, njëkohësisht, mori vendim që emrat e 24 prokurorëve të zgjedhur të dërgohen për dekretim tek Presidentja e vendit;



3. Trajtoi kërkesën e një anëtari të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me rishikimin e pagës së tij dhe shtesave, si dhe autorizoi Komisionin për Çështje Normative që të përgatitë një analizë me rekomandime për këtë rast dhe rastet e tjera të ngjashme.